

V E N D I M

Nr.23, datë 21.1.1999

PËR SHPËRBLIMIN E PUNONJËSVE TË SHOQËRIVE TREGTARE, QË PRIVATIZOHEN

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 129, 214, 215, të ligjit nr.7938, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në shoqëritë tregtare, që privatizohen, të cilat janë në procesin e shitjes së paketës së aksioneve të tyre, dhe gjatë veprimtarisë rezultojnë të kenë rritur vlerën e kapitalit themeltar, e vazhdojnë të konkurrojnë në treg, punonjësit e tyre përfitojnë deri në 12 paga mujore nga fitimi neto, i realizuar, i vitit ushtrimor. Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, në shpërndarjen e fitimit neto të realizuar nga shoqëria tregtare, përcakton, nga dividendi, shumën që u takon punonjësve.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko